VENDIM
Nr. 160, datë 28.12.2015

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "GSA" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 57, DATË 22.6.2011

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "d"; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "g"; 13 dhe nenit 16 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "GSA" sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GSA" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat "a", "b","c") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë "GSA" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.57, datë 22.6.2011, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet